



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/84

Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 73, 74 dhe 78 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet; 75, 76, 77, 79 dhe 80 elektronike\ korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2022**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2022 si në vijim:
  - 1.1 Shtohen në Programin Legjislativ për vitin 2022:
    - 1.1.1 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës (MASHTI), afati i miratimit në Qeveri 30.11.2022;
    - 1.1.2 Projektligji për Performancën Energjetike në Ndërtesa (MMPHI), afati i miratimit në Qeveri 30.12.2022;
    - 1.1.3 Projektligji për Planifikim Hapësinor (MMPHI), afati i miratimit në Qeveri 30.12.2022;
    - 1.1.4 Projektligji për Inspektime Shëndetësore (MSh), afati i miratimit në Qeveri 30.12.2022.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit që Vendimin t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Traktatit mbi Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Rregullorja për Koordinimin ndërmjet Institucioneve të Republikës së Kosovës për Deminim Humanitar.
2. Obligohet Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Agjencia e Statistikave e Kosovës nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve bartet në Zyrën e Kryeministrit.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Zyra e Kryeministrit që në pajtim me legjislacionin në fuqi të ndërmarrin të gjitha masat ligjore, financiare dhe administrative për bartjen e Agjencisë së Statistikave të Kosovës.
3. Ndryshimet e nevojshme të reflektohen gjatë përgatitjes së Buxhetit për vitin 2023.
4. Me këtë Vendim shfuqizohet pika 1. (një) e Vendimit të Qeverisë Nr.03/09, të datës 1 korrik 2020.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/84

Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 2 të Ligjit Nr. 04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, nenit 11 të Statutit të Këshillit Konsultativ për Komunitete, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 03/34 i datës 7 tetor 2020, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 10/67 të datës 9 mars 2022, për nominimin e përfaqësuesve të Qeverisë Republikës së Kosovës në Këshillin Konsultativ për Komunitete si në vijim:
  - 1.2. Në vend të z. Lidon Pajaziti, propozohet znj. Nuriye Shala, Këshilltare e Kryeministrit të Republikës së Kosovës; dhe
  - 1.3. Në vend të z. Suhat Ademi, propozohet z. Slaviša Mladenović, Komisioner për Gjuhët.
2. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë Nr. 03/34 të datës 7 tetor 2020, mbeten të pandryshuara.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin t'ia procedojë Këshillit Konsultativ për Komunitete i cili vepron nën ombrellën e Presidentes së Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/84

Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme dhe Masat e tjera Mbrojtëse.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. I propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës Ratifikimi i anëtares ndërkombëtare të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) të Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA-së), znj. Maja Martinović, Ph.D.
2. Anëtarja e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) të Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA-së), zgjidhet me mandat të caktuar për 5 (pesë) vite.
4. Obligohet Sekretari i përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin së bashku me biografinë e të propozuarës nga pika 1. e këtij Vendimi, t'ia dërgoj Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 20,721.00 € ( njëzetë mijë e shtatëqind e njëzet e një euro) për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2022 në Qendrën Rajonale të Nismës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjat (MARRI), me seli në Shkup.
2. Shuma në vlerën e përcaktuar në pikën 1. të këtij Vendimi ndahet nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve, nga programi Shërbimet e Administratës Qendrore – MPB me kodin 11314, dhe barten në xhirrollogarinë IBAN: MK 07300702000289886 EUR, S.W.I.F.T.: KOBSMK2X, Komercijalna Banka A.D. Skopje.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9 paragrafi 3 i Ligjit nr.04/L-219 për të Huajt i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huajt, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 15/50 të datës 23 dhjetor 2021**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 15/50 i datës 23 dhjetor 2021 për emërimin e Komisionit të Ankesave për të Huajt, si në vijim:
  - 1.2. Në vend të znj. Kaltrina Nuhiu, nga Ministria e Drejtësisë, zëvendës kryesuese emërohet znj. Valmira Maxhuni-Uka.
  - 1.3. Në vend të z. Arben Kçira nga Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar i Komisionit emërohet z. Naim Hajdini.
2. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 15/50 të datës 23 dhjetor 2021.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/84  
Datë: 22.06.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 14 pika 3. të Ligjit Nr.08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej: 3,000,000.00 €, (tre milionë euro) në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me kod 212, nën-programi Administrata Qendrore me kod 11312, nga kategoria e shpenzimeve kapitale konkretisht nga projekti: kapital "Bashkëfinancimi me donatorët për skemën e granteve bazuar në performancën komunale" me kod 15525 në 25 (njëzet e pesë) projekte kapitale në përputhje me 25 (njëzet e pesë) marrëveshjet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara nga Ministri i MAPL-së, Kryetarët e Komunave dhe donatorët.
2. Mjete nga pika 1. e këtij Vendimi rialokohen nga projekti: "kapital "Bashkëfinancimi me donatorët për skemën e granteve bazuar në performancën komunale" me kod 15525 në këto projekte të reja, konform shumave të cekura si në vijim:
  - 2.1. Ura automobilistike në fshatin Grabovc rruga Roga- Komuna e Obiliqit, vlera e projektit 223,140.75 €;
  - 2.2. Ndërtimi i rrugës "Riza Krasniqi" në Breznicë - Komuna e Obiliqit, vlera e projektit 150,000.00 €;
  - 2.3. Furnizimi me pajisje për nevojat komunale, Komuna e Obiliqit, vlera e projektit 435,000.00 €;
  - 2.4. Rregullimi i hapësirave të jashtme dhe renovimi i shkollës ShMFT " Shaban Spahija" komuna e Pejës, vlera e projektit 50,000.00 €;
  - 2.5. Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në lagjen " Kapeshnica", "Haxhi Zeka " dhe lagjen "Rrokaqielli" - Komuna e Pejës, vlera e projektit 40,000.00 €;
  - 2.6. Ndërtimi i fushës së sportit pranë shkollës së mesme të Mjekësisë në Pejë"- Komuna e Pejës vlera e projektit 40,000.00 €;
  - 2.7. Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në fshatin Vitomiricë- rruga "Mulla Zekë Bërdyna" -Komuna e Pejës, vlera e projektit 71,186.71 €;
  - 2.8. "Ndërtimi i mureve rrethuese të varrezave në komunën e Pejës"- Komuna e Pejës vlera e projektit 90,000.00 €;
  - 2.9. Blerja e Paragllajdave dhe pajisjeve përcjellëse - komunën e Pejës, vlera e projektit 30,000.00 €;
  - 2.10. Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugën "Uesli Klark në Pejë - Komuna e Pejës", vlera e projektit 50,000.00 €;

- 2.11. Ndërtimi i Urës për këmbësor në lagjen "Puhovci", Komuna e Pejës vlera e projektit 20,000.00 €;
  - 2.12. Ndërtimi i ndriçimit publik dhe trotuari në shkollën gjimnazi "Bedri Pejani" në fshatin Svek, Bllagejë dhe Nabergjan,- Komuna e Pejës, vlera e projektit 90,000.00 €;
  - 2.13. Ndërtimi i ndriçimit publik në lagjen "Dardania III", fshatin Ruhot dhe ndërtimi i trotuarit në fshatin Zllapek, - Komuna e Pejës vlera e projektit 90,000.00 €;
  - 2.14. Ndërtimi i trotuarit përgjatë rrugës Vitomiricë - Novosellë faza e dytë, ndërtimi i trotuarit në lagjen Dardania II dhe rregullimi i varrezave të dëshmoreve në varrezat e qytetit të Pejës"- Komuna e Pejës vlera e projektit 90,000.00 €;
  - 2.15. Rregullimi i hapësirave Sharra - Gryka e Rugovë - Komuna e Pejës, vlera e projektit 100,000.00 €;
  - 2.16. Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës që lidhë vendbanimet Gërllicë-Kaçanik i vjetër-Stagovë-Runjevë ( segmenti Stagovë-Runjevë) - Komuna e Kaçanikut, vlera e projektit 236,057.29 €;
  - 2.17. Ndërtimi i objektit për zjarrfikës Kaçanik - Faza e parë - Komuna e Kaçanikut, vlera e projektit 70,000.00 €;
  - 2.18. Kanalizimi fekal Livoq i Epërrm - Livoq i Ulët dhe një pjesë e lagjes "Kodra e Thatë"- Komuna e Gjilanit, vlera e projektit 384,335.28 €;
  - 2.19. Asfaltimi i rrugëve në fshatin Haxhaj - Komuna e Gjilanit, vlera e projektit 110,490.99 €;
  - 2.20. Asfaltimi i rrugëve në fshatin Cernicë - Komuna e Gjilanit vlera e projektit 80,865.93 €;
  - 2.21. Terrenet sportive - Komuna e Gjilanit vlera e projektit 288,614.15 €;
  - 2.22. Rregullimi i parkut Rr. "Isa Berisha" - Komuna e Hanit te Elezit, vlera e projektit 82,554.64 €;
  - 2.23. Rregullimi dhe riparimi i rrugës "Mbretëresha Teutë" - Komuna Mitrovicë Jugore, vlera e projektit 61,367.39 €;
  - 2.24. Rregullimi stazës te shkolla fillore "K.Milutin", prej rrugës "K.Milutin" deri te banesat Padalishtë - Komuna e Graçanicës, vlera e projektit 81,660.91 €;
  - 2.25. Rregullimi i pjesës së rrugës nga Lovaci deri te Kopshti i fëmijëve në Shtërpçë - Komuna e Shtërpçës, vlera e projektit 34,725.96 €.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për zbatimin e këtij Vendimi.
  4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 12/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8, nenit 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozim-vendimi për hartimin e Planit Hapësinor të Kosovës (PHK).
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) që të ndërmerret të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës bashkërendon grumbullimin e të gjitha raporteve për zhvillim strategjik të sektorëve qeveritarë dhe të njëjtat ia dorëzon MMPHI-së si dhe i obligon të gjitha institucionet publike në nivel qendror e lokal që të mbështesin dhe ndihmojnë MMPHI-në me qëllim të sigurimit të informatave më të reja të nevojshme për hartimin e PHK-së.
4. Programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit është pjesë e këtij Vendimi ashtu siç parashihet në nenin 9. paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.
5. Pas miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ky Propozim-vendim procedohet për aprovim përfundimtar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, siç parashihet në nenin 7 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 13/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 dhe nenit 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3 dhe nenin 14 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozim-vendimi për hartim të Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri" (PHPK "Sharri").
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që të ndërmerret të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.
3. Programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit është pjesë e këtij Vendimi, ashtu siç parashihet në nenin 9. paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.
4. Pas miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ky Propozim-vendim procedohet për aprovim përfundimtar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, siç parashihet në nenin 7 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 14/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M P R E L I M I N A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat gjenden brenda Lokacionit të "Aeroporti i Gjakovës" për nevoja të realizimit të projekteve infrastrukturore të Ministrisë së Mbrojtjes, zonat kadastrale: Bec, Trakaniq dhe Janosh të Komunës së Gjakovës, sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës, pas miratimit, të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilëndo pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cilido person që është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Mbrojtjes.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 15/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani i Veprimit 2022-2024 i Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë 2022 - 2030.
2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e Planit të Veprimit nga pika 1. e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 16/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë 2022-2026 dhe Plani i Veprimit 2022-2024.
2. Koordinator Nacional për Strategjinë Kombëtare Kundër Trafikim me Njerëz caktohet Ministri i Punëve të Brendshme, i cili këtë përgjegjësi mund ta delegojë te njëri nga zëvendësministrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 17/84

Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes dypalëshe për bashkëpunimin për zhvillim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 18/84

Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për zbatimin e Marrëveshjes dypalëshe në lidhje me bashkëpunimin për zhvillim.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 19/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për Amendamentimin 2. të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2015.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 20/84

Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për Amendamentimin 2. të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2018.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 21/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për themelimin e Fondit të Konfiskimit.
2. Obligohen Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 22/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-034, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Pasuritë e konfiskuara me vendim gjyqësor të formës së prerë e të cilat administrohen nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, do të jepen në shfrytëzim për nevoja të institucioneve qendrore apo lokale.
2. Me rastin e dhënies në shfrytëzim të pasurisë nga pika 1. e këtij Vendimi, do të merren për bazë kriteret e mëposhtme:
  - 2.1. Interesi i përgjithshëm;
  - 2.2. Parimet e miradministrimit të pasurisë;
  - 2.3. Fushëveprimin, përkatësisht përgjegjësitë e institucionit të cilit i jepet e drejta e shfrytëzimit të pasurisë;
  - 2.4. Përparësi do kenë institucionet e fushës së sigurisë, institucionet që merren me trajnimin dhe rehabilitimin e viktimave të krimit, si dhe institucionet të cilat merren me trajtimin e rasteve sociale.
3. Për dhënien në shfrytëzim të pasurive nga pika 1. (një) e këtij Vendimi, institucioni duhet të paraqesë kërkesë përkatësisht shprehje interesit tek Ministria e Drejtësisë/Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë si dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 23/84  
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 57 paragrafi 1. të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Shfuqizohet Vendimi Nr.12/26 i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 21 gusht 2020, i plotësuar/ndryshuar me Vendimin Nr.03/52 të datës 24 dhjetor 2020.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Për shkak të ndryshimit të rrethanave ligjore dhe faktike, që kanë çuar te pamundësia e funksionimit të Bordit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë